



ProCredit Bank

ProCredit Bank Sh.A, Zyra Qëdre – Rr. George Bush, Nr.26, 10000 Prishtinë, Kosovë


 ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER
LEKARSKA KOMORA KOSOVA

 Nr. Prot.: 187/2025
 Br. Prot.:
 Nr. i faqeve: -06-
 No. of pages:
 Br. stranica:
 Data: 01.09.2025
 Datum:
 Prishtinë/s

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT



Lidhur ndërmjet:

- **ProCredit Bank Sh.a.**, me adresë Bulevardi Nëna Terezë nr. 16, Prishtinë, me numër unik identifikues 810487191, dhe me numër të regjistrimit të biznesit 70050026 dhe
- **Oda e Mjekëve të Kosovës** me adresë në QKUK, INSTITUTI A, KATI III - Prishtinë, me numër fiscal 601733224

Neni 1.

LËNDA

- 1.1 Me anë të këtij dokumenti Banka ProCredit dhe Oda e Mjekëve të Kosovës hyjnë në këtë Memorandum Mirëkuptimi, përmes së cilit Banka ofron kushte speciale për shërbime bankare për të gjithë mjekët anëtar të **Odës së Mjekëve të Kosovës**
- 1.2 Qëllimi i këtij Memorandumi është të nxisë bashkëpunimin midis palëve, dhe të lehtësojë qasjen në produktet dhe shërbimet bankare pranë Bankës ProCredit

Neni 2.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 2.1 Me anë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, Banka ProCredit dhe Oda e Mjekëve të Kosovës bien dakord për bashkëpunim, në kuadër të të cilit Banka do të ofrojë kushte të veçanta për shërbime bankare për të gjithë mjekët anëtar të Odës.
- 2.2 Qëllimi i këtij Memorandumi është të forcojë bashkëpunimin ndërmjet palëve si dhe të lehtësojë qasjen e anëtarëve të Odës në produktet dhe shërbimet bankare të ofruara nga Banka ProCredit.
- 2.3 Përfitimet e anëtarëve të Odës nga ky Memorandum Bashkëpunimi do të jenë të mundura vetëm pas nënshkrimit të këtij Memorandumi nga të dy palët, dhe se i njëjti nuk prodhon efekt retroaktiv për kontratat e nënshkruara para datës së nënshkrimit të këtij Memorandumi.



ProCredit Bank Sh.A, Zyra Qëndrore – Rr. George Bush, Nr.26, 10000 Prishtinë, Kosovë

Neni 3.

PËRFITIMET E MJEKËVE ANËTARË TË ODËS

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Banka ProCredit do të ofrojë gjithashtu një gamë shërbimesh jo-financiare, të cilat synojnë të përmbushin dhe lehtësojnë nevojat për shërbime bankare të të gjithë anëtarëve të Odës.

Poashtu, në përpjekje për t'ju mbështetur në çdo hap të rëndësishëm në jetën tuaj, nga shkollimi i fëmijëve deri te realizimi i planeve personale dhe familjare, ne ofrojmë **norma preferenciale të interesit për kredi**, të dizajnuara posaçërisht për t'ju ndihmuar të kurseni më shumë dhe të paguani më pak.

Këto shërbime përfshijnë:

- Për të gjithë mjekët që kalojnë pagat në Bankën ProCredit para datës 31 Dhjetor 2025, Banka merr përsipër detyrimin që t'ua paguaj anëtarësinë e ardhshme vjetore pranë Odës së Mjekëve të Kosovës;
- Pako e shërbimeve bankare **FALAS PËR TËRË JETËN** për të gjithë mjekët anëtarë të Odës, përmes Pako ZERO, e cila përfshinë të gjitha shërbimet e mëposhtme:
 - ✓ Mirëmbajtja e të gjitha llogarive
 - ✓ Debit kartela
 - ✓ Deponimet dhe tërheqjet falas në ATM të Bankës ProCredit
 - ✓ Tërheqje në POS nga dyqanet dhe kompanitë partnere të Bankës
 - ✓ Pranimi i pagës pa asnjë komision
 - ✓ E-banking
 - ✓ Mobile banking
 - ✓ Transferta ndërmjet llogarive të të njejtit klient dhe brenda ProCredit Bank me e-Banking
 - ✓ Pagesat për institucione publike, universitete, shkolla private, ambasada dhe kompani sigurimesh në e-Banking
 - ✓ Ndryshimi i PIN-it në m-Banking dhe për herën e parë në bankomat
 - ✓ Ri-aktivizimi i PIN-it pas tentativave të gabueshme
 - ✓ Kthimi i kartelës së mbetur në bankomat
 - ✓ 3D Secure PIN



ProCredit Bank Sh.A, Zyra Qendrore – Rr. George Bush, Nr.26, 10000 Prishtinë, Kosovë

- Për të shpërblyer besimin tuaj, ne ofrojmë norma preferenciale të interesit për depozita me afat 6 dhe 12 mujor, pavarësisht shumës së afatizuar, sipas tabelës në vijim:

Depozitat me afat		
Shuma (EUR)	Periudha e afatizimit (muaj)	Norma Nominale Vjetore e Interesit
E pa përcaktuar	6 dhe 12	3.0%

- Banka do t'i mbështes anëtarët e Odës së Mjekëve përmes financimit të kostos së specializimeve, sub-specializimeve dhe studimeve të doktoratës me **kredi pa interes**, deri në vlerën prej EUR 5,000 dhe me maturitet deri në 36 Muaj. Do të aplikohen vetëm shpenzimet administrative prej 1.5% të shumës së kredisë.
- Banka do t'i mbështes anëtarët e Odës së Mjekëve në përballimin më të lehtë të kostos së shkollimit të fëmijëve të tyre përmes kredisë pa interes, e cila do të ofrohet mbi bazën e marrëveshjeve të partneritetit me disa nga institucionet arsimore në Kosovë me të cilat Banka ka marrëveshje bashkëpunimi. Do të aplikohen shpenzime administrative prej 1.5%.
- Banka do të ofroj fleksibilitet në kërkesat për kolateral në financime, duke mundësuar financime pa hipotekë deri në vlerën prej EUR 50,000 dhe maturitet deri në 7 vite, pavarësisht destinimit të kredisë.
- Banka do të ofrojë mundësi të financimit për blerje të patundshmërive në Kosovë dhe Shqipëri përmes kompanive partnere të bankës, me maturitet deri në 360 muaj dhe pa hipotekë shtese (aseti i financiar merret/regjistrohët hipoetekë në të ardhmen, sapo të pajiset me çertifikatë pronësie)
- Banka do të ofrojë normë preferenciale interesi prej 3.9%, fikse për 5 vitet e para, për të gjitha investimet ne blerje te patundshmërive, pavarësisht shumës së kredisë. Pas vitit të 5-të do të aplikohet normë variabile, e bazuar në indeksin EURIBOR 6 mujor, duke aplikuar një prag minimal prej 3.7% pas vitit të 5-të. Shpenzimet administrative do jenë 0.5%.



ProCredit Bank Sh.A, Zyra Qëndrore – Rr. George Bush, Nr.26, 10000 Prishtinë, Kosovë

- Banka do t'i mbështes edhe investimet tjera, si: renovim të shtëpive dhe banesave, përmirësim i kushteve të banimit, investimet private dhe konsumuese, përmes kredisë së bute me normë të interesit prej 4.5% dhe shpenzime administrative 0.5%
- Transferimi i kredisë ekzistuese nga banka tjetër në bankën ProCredit ofrohet me normë interesi prej 10% më të lirë se norma aktuale e kredisë aktive në bankën tjetër (min 3.7%). Shpenzimet administrative janë 0%.
- Banka do të mbështesë investimet e anëtarëve të Odës së Mjekëve të cilët kanë edhe ordinancat e tyre private, dhe të cilët në kapacitetin e tyre si persona fizik, respektivisht të vetëpunësuar, investojnë në pajisjet e nevojshme të punës në ordinancë, si blerja e karrigave stomatologjike, ultrazërit dhe pajisje tjera të nevojshme për funksionalizim të ordinancës. Këto financime do të jenë deri në vlerën EUR 50,000 dhe me maturitet deri në 7 vite, pa hipotekë, dhe me normë të interesit prej 5%, ndërsa shpenzimet administrative do të jenë 1%.
- Ofertë speciale të bankimit dhe financimit të Ordinancave private të të gjithë mjekëve që marrin pagë përmes Bankës ProCredit ose që e kalojnë pagën në Bankën ProCredit.
- Ofrimi pa pagesë i Qendrës së Trajnimeve të Bankës për nevoja të Odës. Kjo Qendër ka kapacitet deri në 100 pjesëmarrës dhe ofron të gjitha kushtet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve, seminareve dhe kongreseve të ndryshme.



ProCredit Bank Sh.A, Zyra Qëndrore – Rr. George Bush, Nr.26, 10000 Prishtinë, Kosovë

Neni 4. PËRGJEGJËSITË E ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

- Do të informojë të gjithë anëtarësinë e saj për disponueshmërinë e Ofertës që përmban ky Memorandum Mirëkuptimi, respektivisht përfitimet nga shërbimet bankare të ofruara nga Procredit Bank.
- Do t'i sigurojë Bankës ProCredit hapsirën e nevojshme për shpalosje/prezantim të benefiteve të këtij memorandumi tek anëtarësia e saj me dakordim paraprak ndërmjet palëve.
- Do t'ia mundësoj Bankës ProCredit vendosjen e materialeve promovuese në hapsirat/ambientet e Odës si dhe në të gjitha aktivitetet e saj, si: punëtori dhe kongrese të ndryshme.
- Do t'a shpërndaj ofertën tonë tek e gjithë anëtarësia përmes postës elektronike (e-mail tek anëtarët e Odës).
- e. Do të inkurajojë anëtarësinë e saj që t'i përgjigjen pozitivisht ofertës tonë dhe të përfitojnë nga mundësitë e shumta që ProCredit Bank u ofron.

Neni 5. KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

3.1 Secila palë pajtohet që informatat të mbajë konfidenciale, përderisa informatat e tilla kanë vlerë komerciale, çfarëdo informata të palës tjetër të cilat janë Informata Afariste Konfidenciale dhe të mos shfrytëzojë Informatat Afariste Konfidenciale të tilla përveç gjer në masën që duhet për të zbatuar Memorandumin.

3.2 Në rastet kur pala/Furnitori bie në kontakt me të dhëna personale sipas këtij Memorandumi dhe të dhënat e tilla personale menaxhohen apo mbahen nga Banka, pala/Furnitori pajtohet t'i nënshtrohet standardeve evropiane, sipas Ligjit në fuqi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe çfarëdo rregullore në lidhje me të



ProCredit Bank Sh.A, Zyra Qëndrore – Rr. George Bush, Nr.26, 10000 Prishtinë, Kosovë

dhënat personale dhe pajtohet të përpunojë të dhënat e tilla personale vetëm në përputhje me udhëzimet e Bankës.

Neni 6**KOHËZGJATJA DHE MËNYRA E NDËRPRERJES**

4.1 Memorandumi hynë në fuqi me nënshkrimin e palëve dhe do vlejë deri me datë 31 Dhjetor 2025.

Neni 7**TË NDRYSHME**



5.1 Asnjë e drejtë nga ky Memorandum nuk i jepet ndonjë palë të tretë dhe nuk mund të shfrytëzohet për paraqitjen e çfarëdo pretendimi ndaj Bankës, përveç nëse Banka e lejon në mënyrë specifike një pretendim të tillë.

5.2 Kjo Marrëveshje përmban dakordimin e plotë të palëve dhe përbën një deklaram të plotë dhe ekskluziv të rregullave dhe kushteve lidhur me çështjet që janë referuar në këtë Memorandum.

5.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të vijë nga Memorandumi, palët do të bëjnë përpjekje ta zgjidhin në mënyrë miqësore. Nëse nuk mund të gjendet ndonjë zgjidhje e pranueshme, atëherë palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente.

5.4 Memorandumi është përpiluar në 2(dy) ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë, secili prej tyre e nënshkruar në mënyrë të rregullt nga të dy palët kontraktuese dhe në zbatim me efekt të barabartë juridik.

5.5 Palët e këtij Memorandumi nuk do të lejojnë që asnjë pjesëtar i personelit të tyre, të ketë ndonjë përfitim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ky Memorandum dhe pajtohen që shkelja e kësaj dispozite, do të interpretohet si shkelje e këtij Memorandumi.

ProCredit Bank:**Date: 01/09/2025****Oda e Mjekëve të Kosovës:****Date: 01/09/2025**